



Dalës-Izlazna

Nr. J-88  
Br.

Data 21.06.2022  
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.26.05.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiçi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiçi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Valon Svirca (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

**Të pranishmit tjerë:** Ibush Mjekiçi, Nënkyetar i Komunës, Slavisa Jakovljevic, Nënkyetar për komunitete, drejtorët komunal dhe Burim Gërguri, shef i kabinetit të Kryetarit

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiçi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

**R E N D I T E**

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Obiliqit
4. Shqyrtimi i Marrëveshje zotimi në mes të Komunës së Obiliqit dhe Postës
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

**Kryesuesja** - I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 12 vota për dhe 5 vota abstenim.

**Pika 1 e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

**Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 12 vota për dhe 6 vota kundër.

**Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Për një sqarim më detal të Draft Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Obiliqit, fjalën ia dha drejtoreshës së Drejtorisë së administratës së përgjithshme.

**Lendita Bekteshi Memishi** – Ju njoftoj se Komisioni pas marrjes së vendimit nga Kryetari i Komunës, menjëherë ka filluar punën rreth kësaj Draft Rregulloreje. Ky Komision prej 5 anëtarëve, ka punuar sipas Udhëzimit administrativ nr.02/2019 dhe me ndihmën e përfaqësuesit nga demokracia plus Komisioni ka hartuar këtë Draft Rregullore për nevojat e Komunës tonë. Kjo Draft Rregullore është publikuar edhe në web faqen e Komunës, ndërsa diskutimi publik është mbajtur me dt.05.05.2022 ne ora 14 në sallën e

Kuvendit komunal. Gjatë diskutimit publik ka pasë propozime që Kryetari i Këshillit të ndërrohet me rrotacion, por kjo çështje nuk është e rregulluar me Udhëzim.Tash, duhet të aprovohet Draft Rregullorja, të emërohet Komisioni për zgjedhjen e Këshillave lokale, i cili duhet ti ketë 7 anëtarë, 4 anëtarë prej Kuvendit, 1 anëtarë nga Ekzekutivi, 1 nga shoqëria civile dhe 1 anëtar si përfaqësues i fshatit ku bëhet zgjedhja e Këshillit lokal.

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që të formohen Këshillat e fshatit, që është një vazhdimësi sepse edhe më heret Këshillat kanë qenë. Unë e kam një vërejtje te zona e 4, prej nga edhe unë vijë nga fshati Dardhishtë, është bashkë me Shkabaj, ose me Haden e Re dhe këtu në hartë është në rregullë, por në mes është krejtë KEK-u si dhe gjeografikisht bukur shumë janë të ndarë. Prandaj, më mirë kishte me qenë që ajo pjesë e Shkabajt me shkue me Mazgit ose ndoshta edhe me Obiliq, se sa me mbetë me Dardhishtë sepse gjeografikisht janë largë.

**Sami Ahmeti** – Edhe ne vlerësojmë se kjo Rregullore ndihmon në funksionalizimin e Këshillave të fshatrave dhe i ndihmon zhvillimit të fshatrave të lagjeve në raport me Komunën. Ne kemi disa vërejtje, që besoj se më shumë janë teknike, por janë edhe esenciale. Te faqja nr.4, neni 8, pika 1, thotë se kandidatët për anëtarë të Këshillave locale, duhet të jenë banorë të përhershëm në këtë lokalitet. Ne mirëkuptojmë se duhet të jenë banorë të përhershëm, por mendojmë se kjo pikë duhet të ndryshoj me kandidatët për anëtarë të Këshillave lokale, duhet të jenë banorë të atij lokaliteti së paku 5 vitet e fundit sepse për 5 vite njerëzit marrin nënshtetësi, e jo me qenë një anëtar i një Komiteti në të mirë të lokalitetit. Pastaj, menjëherë pas kësaj flitet për qysh me bë verifikimin e këtyre kandidatëve që janë banorë të atij lokaliteti. Ne mendojmë se duhet ti shtohet prapa saj pika verifikimi i anëtarëve bëhet me dokument të identifikimit të Republikës së Kosovës, e të njejtit evidentohen dhe nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes në votim. Besoj se nuk është diçka e madhe, por është shumë esenciale me qenë në këtë Rregullore. Te neni 10, renditja është 1,2,2,3,4, do të thotë renditja ka gabime te pikat që edhe te kjo duhet të bëhet një përmirësim. Pastaj, pika 2 bie ndesh me pikën 4, respektivisht 5 që do të bëhej. Psh te pika 2, thuhet që procedura e shkarkimit të Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal bëhet sipas procedurës së zgjedhjes. Në ndërkohë në pikën 4, thuhet se zëvendësimi i anëtarëve të Këshillave lokale me rastin e humbjes së mandatit bëhet nga lista e pritjes, nga cila listë. Ne mendojmë që në zëvendësimin e anëtarëve të Këshillave lokale me rastin e humbjes së mandatit bëhet duke përsëritur zgjedhjet në atë lokalitet dhe kjo duhet kështu të shkruhet. Mund të ketë edhe vërejtje tjera, por në parim ne jemi për këtë Rregullore me këto ndryshime, që nuk i bëjnë dëm askujt, vetëm se e bëjnë më të plotfuqishëm këtë dokument.

**Ajet Berisha** – Pajtohem në plotëni, që është në harmoni edhe me Rregulloren dhe Udhëzimin administrativ, përveç se në bazë të regjistrimit të popullsisë ka të drejtë që i takojnë 12 Këshilla lokale të organizimeve, por praktikisht në bazë të informatave që i kemi jozyrtare në Komunën e Obiliqit, nuk jetojnë më shumë se 17,000, ose 18,000 banorë dhe nga kjo delë se duhet të ishin 8 Këshilla të organizuar në bazë të popullatës. Mirëpo, nga regjistrimi zyrtar janë 12, që drejtoresha ka të drejtë. Për ndarjen e lokacioneve dhe kush në cilin lokalitet, apo Këshill i përket, mendoj se ndoshta ka hapësirë për diskutim dhe në këtë drejtim është dashur të përfshihet edhe Millosheva e Baimoci bashkë, ose edhe Plemetini me Obiliqin e vjetër, kështu që edhe kishte me u zvoglue numri i Këshillave dhe kishte me u bë më praktik organizimi. Ndërsa, me pjesën tjetër pajtohem plotësisht.

**Hamit Mjeku** – Ne si Komision nuk kemi diçka me shtue. Te zona e 4, që e ceku z.Enver, ne kemi shkue me qëllim që me bashkue edhe atë pjesën, por ne jemi pro edhe nëse propozoni ti bashkangjitet Mazgitit të lartë dhe të ulët si zonë. Te Sami Ahmeti, pika 1, është teknikisht dhe atë çështje e rregullojmë. Te verifikimi me letërnjoftim ishte edhe te neni 10, nuk paraqet diçka problem sepse nënkupton se në çdo zgjedhje duhet me pasë kartën e identitetit me të cilën i nënshtrohet zgjedhjes.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht morën Vendim për aprovinim e Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Obiliqit.

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Ju njoftoj se e kemi rekomandimin e KPF-së, për shqyrtimin e marrëveshje zotimit, po kërkohet që të autorizohet Kryetari i Komunës, për fillimin e negociatave për arritjen e marrëveshjes në mes të Komunës së Obiliqit dhe Postës së Kosovës. Për hir të transparencës është dorëzuar te ju kjo Draft marrëveshje. Sipas ligjit nr.06/L -092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës neni 8, pika 1.3, nuk e obligon Kryetarin e Komunës të kërkoj autorizim nga Kuvendi komunal për fillimin e negociatave për lidhjen e marrëveshjeve të tilla. Mirëpo, për hir të transparencës, Kryetari po kërkon autorizim që të filloj negociatat për një marrëveshje të mundshme, i cili pas arritjes së marrëveshjes është i obliguar që ta sjellë në Kuvendin komunal për shqyrtim dhe aprovim.

**Enver Gashi** – Ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

**Sami Ahmeti** – Ju veç e potencuat se Kryetari e ka kompetencën e plotë që të bëjë marrëveshje, të bisedoj për diçka për të mirën e qytetarëve. Këtë Draft marrëveshje të sjellë këtu, e posaqërisht këtë të dytën që na e keni dhënë në mbledhjen e KPF-së, unë mendoj se vetëm marrëveshje nuk është për faktin se është e njëanshme dhe ka edhe pika që mund të quhen edhe shantazhuese. Për shembull te obligimi i Postës së Kosovës, obligohet posta ta tërheqë padinë e bërë ndaj Komunës dhe shumë gjëra tjera. Mbi të gjitha dislokimi i postës në një pikë periferike qysh janë banesat e Hades, do të thotë lokalet e banesave të Hades, mendojmë se nuk i bëjnë nder këtij aseti shtetëror dhe përveç kësaj parashihet me këtë Rregullore rrënim i këtij objekti. Ne mendojmë se është gabim rrënim i këtij objekti për faktin se nuk është i dëmtuar dhe ka mundësi të renovohet. Ne si grup parlamentar propozojmë që edhe nëse, posta dislokohet nga aty, ky objekt të adaptohet për nevoja të personave me nevoja të veçanta, që ne i kemi mbi 350 persona. Kjo i plotëson kushtet dhe ka hapësirë, në mënyrë që të iu ndihmojmë edhe kësaj pjese të shoqërisë e cila është e pambrojtur. Unë e di se ju i keni votat, mundeni me votue, por ne do të votojmë kundër dhe gjithsesi nuk do ta lejmë vetëm me votim, por do të shfrytëzojmë të gjitha mekanizmat tjerë, që janë demokratike për pengimin e rrënimin të këtij objekti.

**Ajet Berisha** – Mendoj se për diçka që vet ligji i jepë mundësi apo e parashehë saktë, është krejtë e panevojshme me na ardhë neve Drafte të tilla në periudha të caktuara psh sot. Kryetari e ka autorizimin, ligjërisht obligimin me diskutue dhe me bashkëpunue me cilindo në interes publik dhe për këmbim të hapësirave të ndryshme që janë në interes publik. Në këtë rast i vetmi interes për Kuvendin komunal është se sa e dijmë ne sheshi ka përfundue, ka qenë i planifikuar, i buxhetuar dhe i përfunduar. Pyes ka ndonjë plan tjetër se fatkeqësia është se Komuna e Obiliqit nuk ka plan zhvillimor, nuk ka as plane detale të zhvillimit të lagjeve, të hapësirave të caktuara dhe ad-hoc merren vendime aty për aty, po e heqim postën, po e shtojmë një shkollë. Do të thotë se problemi është këtu, e jo te e drejta që ligji ia jepë Kryetarit me bashkëpunue, me bisedue dhe me i ngritë këto nivele në nivel të këmbimit të hapësirave, të tokës, të objekteve në interes publik. Prandaj, krejtë kjo është e panevojshme pse me i ardhë Kuvendit komunal në këtë fazë sepse këtë autorizim e ka Kryetari.

**Arben Berisha** – Ne e kemi bërë një Draft marrëveshje dhe me postën i kemi bërë disa negociata, jemi marrë vesh dhe jemi dakordue që posta duhet të hiqet nga aty. Ju sqaroj se nuk është çështje e kërcënimit, nuk është çështje e dhunës, por prona është pronë komunale që na përket neve. Ne kemi menduar që me postën me trajtue aq mirë çështjen që mos me qenë e njëanshme, por me mirëkuptue postën, se është një aset shtetëror dhe na përket edhe neve. Ajo që kemi menduar është se edhe në të ardhmen edhe kjo nuk e di se si ka me dalë për arsye të dokumentacionit që e posedon posta sepse nuk e ka asnjë dokumentacion që ne mund të hyjmë edhe në shpronësim apo në këmbim, që e ke gabim z.Ajet sepse për këmbim prapë duhet me marrë aprovimin e Kuvendit. Pra, edhe këmbimi duhet të hyj nëpër procedura të Ministrisë, Departamentit të shpronësimit dhe në fund me ardhë për aprovim në Kuvendin komunal. Ne kemi menduar dhe në parim jemi marrë vesh me Kryeshefen e postës, znj.Kadiu, nëse nuk gaboje që atyre me iu ofruet 2 lokale te banesat e Hades 1, dhe me pasë një marrëveshje me ata që e kanë kërkuar edhe një kioskë që me vendos në shesh, që mos me i largue në mënyrën e dhunshme. Përndryshe, ata me një vendim dalin nga aty, por ne nuk kemi dashur me i trajtue në këtë formë, por kemi menduar me i trajtue në formën më të mirë të mundshme dhe me

marrëveshje të tyre ata me lirue. Sa i përket vendimit, ne e kemi vendimin e mëhershëm për sheshin, që edhe posta parashihet në atë vendim të sheshit, jo delë kjo aneks apo kujt ti teket. Ata e kanë një padi në gjyq dhe ne nuk e kemi kërcënue me heqë padinë, por nuk e kanë asnjë bazë ligjore dhe krejtë çka kanë është një leje ndërtimore, që ua kam dërguar edhe juve ta shihni.

**Ajet Berisha** – Unë e di që posta nuk ka qenë, por ka qenë objekti ku e ke ti lokalin me u heqë, që nuk është heqë dhe jeni arsyetue për mjete. Po ashtu, ka qenë me u heqë gjysma e oborrit të policisë në plan ndërsa, posta nuk ka qenë në plan të sheshit. Në rast se është kështu, pse nuk është heqë objekti që jeni arsyetue se nuk keni pasë mjete, apo i keni mbrojtë interesat e juaja, e para. E dyta, pse nuk po diskutoni me policinë për me zhvendosë edhe stacionin e policisë, por në këtë rast të është dhënë rasti për postën, të paska ra në mend. Pse, nuk e heqni objektin ku e ke lokalin tënd, që ka qenë në plan me u heqë.

**Arben Berisha** – Mirë tash, ti po thua, por unë e di që ka dhe nuk merrem me padi sepse nuk jam në domenin tend, sepse mund ta bëjë një padi që kjo të kushton se unë nuk kam lokal aty, kam dikund tjetër, por aty jo. Prandaj, kjo është shpifje dhe dezinformatë për kuvendarët që janë këtu.

**Ajet Berisha** – Ti aty ke pasë lokal, ke marrë qira, e di saktë.

**Kryesuesja** – Ju lutem jeni dalë komplet që të dy nga rendi i ditës dhe këto gjëra i sqaroni jashtë seancës së Kuvendiut komunal.

**Arben Berisha** – Së pari është mirë me kërkue falje sepse kjo të kushton, por nuk mërzhitesh sepse ti non-stop merresh me shpifje.

**Ajet Berisha** – Më i vogli je ti me më tregue për shpifje.

**Kryesuesja** – Ju lutem të keni kujdes për fjalorin që po e përdorni.

**Arben Berisha** – Unë nuk po shprehu keqardhje sepse keq duhet ti vijë atij, e jo mua se kur i thotë dikujt ke një lokal këtu dhe për shkak të pasurisë tënde nuk e rrënon atë lokal, atëherë ti duhet me kërkue falje për me thënë se ke kërkuar një herë në jetën tënde. Mirëpo, nuk ke kërkuar kurrë dhe ti ke problem me vetveten, merru tash me problemet tua. Unë pasurinë e kam deklarue prej fillimit dhe jam shumë krenar. Edhe njëherë po e sqaroj se aty lokal nuk kam dhe pse nuk është rrënue, është në vazhden e rrënimëve dhe aty unë nuk e kam këtë kompetencë. Sa për informim të tjerëve, e jo të tij ne kemi biseduar me policinë dhe policia i ka format e veta që duhet me qenë në mesin e qytetit. Ne ua kemi shpronësue edhe një pjesë që me ua krijue parkingun dhe rrugën.

**Ajet Berisha** – Unë jam anëtar i Kuvendit dhe ke me më dhënë sqarim, por ti nuk e përcakton se a më sqaron mua, apo jo.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 10 vota për dhe 7 vota kundër e aprovuan Vendimin me të cilin autorizohet Kryetari i Komunës, që të filloj negocijimin për arritjen e marrëveshjes në mes të Komunës së Obiliqit dhe Postës së Kosovës, për dislokimin e lokacionit të Postës së Kosovës me qëllim të finalizimit të Sheshit të Qytetit “Dëshmorët e kombit”.

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën nga Sami Saraqi, Kryetar i Shoqatës së invalidëve të UÇK-së, për mbështetje financiare për invalidë për pushime verore në Shqipëri. Sipas rekomandimit të drejtorit të DSHPE-së, mund të aprovohet kërkesa sepse mjete ka duke u bazuar në vijën buxhetore te subvencionet e DSHPE-së.

**Enver Gashi** – Ne jemi për aprovimin e këtij vendimi dhe pasi që kjo temë është diskutuar edhe në KPF, si dhe rekomandimi i drejtorit ka ardhë. Prandaj, atyre vetëm iu dëshirojmë pushim të këndshëm.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 10 vota për dhe 2 vota abstenim e aprovuan Vendimin për kërkesën e Sami Saraqit, Kryetar i Shoqatës së invalidëve të UÇK-së-dega në Obiliq, për mbështetje financiare për 53 invalidë për pushime verore në Shqipëri.

**Kryesuesja** – Ju keni pranuar rekomandimet nga DKRS-ja, lidhur me kërkesat të cilat janë bërë me dt.12.04.2022 dhe kërkesa e parë është e klubit aeronautik “Shqiponjat e Kastriotit”.

**Enver Gashi** – Ne qëndrojmë pas rekomandimit të DKRS-së, vetëm a ka mundësi mjetet të gjenden dhe ata kanë thënë me rishikim të buxhetit.

**Sami Ahmeti** – Te kërkesat, në fakt ka disa kërkesa këtu, e Besnik Mjekut e kemi parë se në bazë të rekomandimit të Drejtorisë së kulturës, kjo është organizatë që sipas ligjit nr.06/L-016, do të thotë në format tjera fitohen këto beneficione. Mirëpo, gjithsesi te këto 2 kërkesa, edhe kërkesa e klubit dhe e paragllajtit ne besojmë dhe kemi fakte se janë pazare të fushatës zgjedhore. Për njërin prej tyre, bile kam edhe inçizim për çka e shfrytëzoj rastin me ftue kushdo që ka interesim prej institucioneve të sigurisë që bëhet planifikim për këtë punë se si do të bëhet gjithsesi për këtë arsye edhe pse ne jemi që ti mbështesim klubet çfarëdo qofshin ato, megjithatë për këtë arsye ne do të votojmë kundër.

**Ajet Berisha** – Unë kisha dashtë që drejtoresha e DKRS-së, me dhënë sqarime rreth përgjegjeve sugjestionuese, e jo me bazë te Rregullorja për subvencionim. Në bazë të sugjestionimit, e jo në bazë të ligjit e Rregullores, por në bazë të ineresit ku e di çfarë drejtoresha përpiqet me tregue se kujt duhet me i ndihmue, e kujt jo. Në përgjegje sugjestionuese është përgjegja që iu ka bërë përfaqësuesit të klubit të KEK-ut, Besnik Mjekut, që në bazë të përgjegjes së dhënë këtu, sugjeron që Kuvendi mos me i ndihmue. Le të më tregon drejtoresha cila pikë e Rregullores aktuale në fuqi e Kuvendit për subvencionim e ndalon subvencionimin e klubit të KEK-ut. Këtu, ka sugjestionue që Besnikut, mos me i ndihmue se është shoqëri aksionare, se këto janë OJQ. Pra cila pikë e Rregullores në fuqi që e ka Komuna e Obiliqit, e ndalon subvencionimin e klubit të KEK-ut. Atëherë, unë kërkoj falje nëse, jam në gabim për këtë përgjegje sugjestionuese që e ka dhënë. Në asnjë pikë të Rregullores për subvencionim të cilësdo qoftë organizatë nuk ndalohet, as për personat, fizik, as juridik, vendosen kriteret dhe subvencionohet. Do të thotë në të njejtin funksion është edhe klubi i KEK-ut, bile është klub që ka një nam, është klub që mbledh afër vetes shumë të rinjë, ka aktivitetin më të madh sportiv në Komunë të Obiliqit dhe më së paku ndihmohet pavarësisht a është shoqëri aksionare, a është OJQ, Rregullorja nuk e ndalon ndihmën ndaj këtij klubi. Le të më thotë drejtoresha se cili nen e ndalon.

**Arba Mirena** – Ju i keni praniar përgjegjet e kërkesave dhe realisht nuk po ndalem në individë me u përgjegjë sepse nuk më duket e rrugës me akuzue për interesa. Ne jemi në shërbim të qytetarëve, ne jemi në shërbim të klubeve sportive, të OJQ-ve, kështu që e juaja është me vendosë për me i aprovue, apo jo ndërsa neve na mbetet ti respektojmë ligjet, Rregulloret në fuqi i nderuari z.Berisha dhe me vazhdue mëtutje. Ne do të jemi transparentë ashtu qysh kemi qenë gjithmonë si Ekzekutiv dhe do të vazhdojmë mëtutje për secilën kërkesë të përgjegjemi. E kemi ligjin nr.06/L-016, për shoqëritë tregtare, janë edhe Rregulloret e Ministrisë së financave për kriteret, standardet, procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe Rregullorja për ndarjen e subvencioneve e Kuvendit komunal. Nuk kemi përgjegje sugjestive, por përgjegjen në fund do ta japë Kuvendi dhe për këtë arsye kërkesat janë dorëzue në Kuvend. Nuk kemi interesa personale, as interesa kolektive, por jemi në shërbim të klubeve sportive, OJQ-ve dhe jemi në shërbim të gjithë atyre, sportdashësve.

**Ajet Berisha** – Nuk mu përgjegjët në pyetjen që e bëra. Rregullorja për subvencionim të organizatave e miratuar në këtë Kuvend, në cilën pikë e ndalon ose jepër sugjerim për me dhënë përgjegje sugjestionuese, se këtij nuk bën me i ndihmue sepse është shoqëri aksionare.

**Ibush Mjekiqi** – Ishim shkue në kërkesat një nga një e mos ti futim në pako. Së pari e analizojmë kërkesën e parë, le të merret vendimi ose mos të merret vendim, pastaj dalim te klubi futbollistik KEK-u. Sigurisht se në Rregullore nuk shkruan se ndalohet subvencionimi i shoqërive aksionare, por sido që të jetë është ligji që e rregullon.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 6 vota kundër e aprovuan Vendimin për kërkesën e Klubit Aeronautik "Shqiponjat e Kastriotit" për mbështetjen financiare të projekt propozimit për blerjen e pajisjeve për Klubin Aeronautik "Shqiponjat e Kastriotit" për zhvillimin e sportit të paragllidingut si atraksion turistik më i ri në Komunën e Obiliqit.

**Kryesuesja** – Për kërkesën nga Besnik Mjeku, fjalën e ka Nënkryetari i Komunës.

**Ibush Mjekiqi** – Klubi futbollistik KEK-u, funksionon për vite të tëra, do të thotë ka një të kaluar jashtëzanosht të gjatë me emër të ndryshëm, por prej vitit 1990 funksionon si klub KEK-u. Në periudha të ndryshme kohore ka funksionue herë si OJQ, pastaj si shoqëri aksionare, por sido që të jetë një klub i tillë

me një traditë të gjatë mendoj se duhet të gjendet forma për mbështetjen e një klubi të tillë. Është shumë e vërtetë se në kuadër të këtij klubi funksionon edhe shkolla e futbollit e cila grumbullon rreth vetes një numër të madh të interesuarve, duke filluar prej moshës 7,8 vjet e tutje. Mendoj se pavarësisht se tani funksionon si shoqëri aksionare, ne duhet ta gjejmë një formë që ta ndihmojmë këtë klub, por kërkoj nga ana juaj që të mbetet për mbledhjen tjetër, në mënyrë që ta gjejmë formën ashtu qysh i kemi subvencionu edhe shoqëritë tjera aksionare.

**Ajet Berisha** – Unë Nënkrjetar, ju siguroj se kërkesa jote për me shtye është e paarsyeshme. Ju siguroj se në kuadër të Rregullores së miratuar nga Kuvendi komunal asnjë pengesë nuk e ka. Meqë, ju siguroj kështu marrë edhe përgjegjësisë asnjë pengesë nuk e ka subvencionimi i shumës që ka kërkuar klubi, në bazë të Rregullores. Unë votova për pikën e parë me kushtin që do të votohen edhe 2 pikat tjera. Në rast se tentoni me i heqë pikat tjera nga ky dokument, atëherë unë e tërheqë votën time për nga pika e parë.

**Ibush Mjekiqi** – Mos paragjyko, z.Ajet që kam ndonjë tendencë. Unë kërkoja me shtye për shkak të buxhetit dhe për asnjë arsye tjetër. Tash, në këtë moment nuk mund të them se po ia ndajmë kaq, apo kaq mjete sepse nuk është analizue. Mendoj se është e nevojshme këtij klubi me i ndihmue dhe nuk po matemi se cili e kemi vullnetin më të madh, sinqerisht po them.

**Ajet Berisha** – Në rast se u kuptua ashtu, nuk e pata qëllimin në raport me ju. Nga përgjegjet kam thënë se është sugjestionuese, jo për juve por për Drejtorinë.

**Ibush Mjekiqi** – Nuk është analizuar sa është shuma e mjeteve dhe kjo ishte arsyeja. Nëse, votohet le të votohet, ne e gjejmë shumën e mjeteve për me subvencionue ose me rishikim, ose në format tjera gjatë periudhës së vitit. Për mua është njëjtë edhe nëse votohet sot, apo shtyhet për mbledhjen tjetër.

**Shaip Paloja** – Unë edhe më heret kam qenë që gjithmonë me iu dalë në ndihmë të klubeve të futbollit dhe në përgjithësi të gjitha sporteve të kulturës. Mirëpo, në këtë rast kur kemi të bëjmë me një shoqëri aksionare, unë kisha kërkuar nëse dikush sot i din emrat e aksionarëve të asaj shoqërie, ose nëse jo në seancën e radhës kërkoj emrat se kush janë aksionarët e atij klubi.

**Ibush Mjekiqi** – Patjetër se obligohet klubi i KEK-ut, me sjellë listën e aksionarëve, kush është pronari, kush janë aksionarët dhe sa kanë aksione.

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën nga Arben Krasniqi për zëvendësimin e bustit të heroit Fahri Fazliu me ngritjen e shtatores së tij në vendin ku gjendet busti i heroit.

**Ajet Berisha** – Unë kam vërejtje te ju, në rast se është ngritë pika për Besnik Mjekun, për klubin e KEK-ut, pse nuk u votua edhe për me shtye në seancën e radhës. Unë pajtohem me sugjerimin, me sugjestionimet dhe këshillat që i ka dhënë se nuk ka buxhet, nuk është planifikue për vitin 2023, dhe unë jam për me u ngritë shtatorja. Mirëpo, ndryshon mënyra e votimit te kërkesa e klubit të KEK-ut dhe nëse është Kuvendi për me shtye këtë kërkesë le te shtyen për mbledhjen e radhës.

**Kryesuesja** – Atëherë po e hudhi në votim kërkesën e Besnik Mjekut që të vjen për aprovim në seancën e radhës me dokumente shtesë dhe me rekomandim nga Ekzekutivi, konkretisht ku merren mjetet dhe nga cila vijë buxhetore.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit unanimisht u pajtuan që të mbetet kërkesa e Besnik Mjekut, klubit FC KEK-u, për seancën e radhës, të plotësohet me dokumente shtesë si dhe të vjen një rekomandim nga Ekzekutivi, që të na specifikoj sa është shuma dhe ku do të merren mjetet në seancën e radhës.

**Kryesuesja** - Paraqet kërkesën nga Arben Krasniqi për zëvendësimin e bustit të heroit Fahri Fazliu me ngritjen e shtatores së tij në vendin ku gjendet busti i heroit.

**Ajet Berisha** - Një sugjerim, subvencionimi i organizatave sportive, nevojave shëndetësore, bujqësore e zhvillimi ekonomik, do të thotë Komuna po planifikon ndarjen e mjeteve si rang i subvencioneve që është dikund 10 %, 8 % është e sigurtë sepse më duket se 800,000 €, janë për subvencionime. Në kuadër të këtyre planifikohen të gjitha ndarjet e subvencionimeve. Kërkesa specifike siç është e klubit dhe kërkesa specifike për bustin dalin ad-hoc, aty për aty, do të thotë nuk janë planifikue në kuadër të këtij buxheti. Unë

e kam edhe një vërejtje sepse mendoj se çështja e bustit jo që është urgjente, çështja e shtatores jo që është urgjente, por për nga pesha konsideroj se kishte me qenë mirë në vitin 2022.

**Ibush Mjekiqi** – Dëshira dhe vullneti ynë është me bë sa më shpejtë që është e mundur dhe ne po kërkojmë që të marrim vendim për ndërtimin e saj. Nuk e kemi kategorinë e subvencioneve, por e kemi kategorinë e investimeve kapitale dhe duhet me marrë vendimin prej Kuvendit, që ne me fillue me hartimin e projektit për ndërtimin e saj. Pastaj, e dijmë koston dhe sa na merrë në Prokurim, kështu që ideja jonë është me mund me realizue në këtë vit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 19 vota për e aprovuan kërkesën nga Arben Krasniqi për zëvendësimin e bustit të heroit Fahri Fazliu me ngritjen e shtatores së tij në vendin ku gjendet busti i heroit.

#### **Pika 6 e rendit të ditës**

**Ajshe Haliti Pllana** – Para se me fillue te kjo pikë e kam një vërejtje, përveç inçizimit që shkon i dobët, kogja dobët shkon kam parë se qytetarët nuk kanë shumë me vazhdue me ato inçizime dhe kur vijmë te pika të ndryshme, 2 mbledhjet e fundit dhe e parafundit nuk ka inçizim. Ju lus nëse, është problem teknik apo ajo punë është diçka tjetër, por tash dojmë deri në fund kishim pasë dëshirë, besoj të gjithë me pasë inçizim.

**Kryesuesja** – Të njejtin shqetësim e kemi edhe ne dhe ne nuk e ndërprejmë inçizimin, përndryshe nuk e kishim obligue sekretarinë me ju thirrë dhe me marrë diskutimin prej juve. Pra, ka qenë gabim teknik dhe komplet seanca e KPF-së, është fshi nga inçizimi dhe këtu është edhe drejtoresha e administratës.

**Lendita Bekteshi Memishi** – Është si shqetësim, por ne jemi vazhdimisht duke komunikue me operatorin vala sepse problemi nuk është te ne, por te operatori vala. Ju kërkojmë falje, por këto janë mundësitë tona sa na përket neve derisa vjen operatori vala me rregullue.

**Labinot Mirena** – Kërkesa ime për sot ka të bëjë me ndërtesat kolektive të dëmtuara, të bëhet fasadimi i pjesëve të jashtme si dhe është e domosdoshme vendosja e ashensorëve nëpër ndërtesa në qytetin e Obiliqit. Shumica e ndërtesave kane telashe me çati dhe fasadimin pasi që janë objekte të ndërtuara kohë më parë, janë amortizuar dhe në disa ndërtesa në çati rrezikohetn edhe banorët poshtë në rrugë. Kërkoj që të bëhet një studim dhe analizë e mundësive, e këtyre objekteve me qëllim që të bëhet montimi i ashensorëve, që do të lehtësonte shumë lëvizjen e personave në moshë dhe fëmijëve si dhe të banorëve për furnizimet ditore që i kanë. Besoj se kërkesa është e arsyeshme dhe kërkoj mirëkuptim prej të gjithë kolegëve se ndoshta, po i lodhi me kërkesa për çdo muaj, por janë kërkesa të qytetarëve të Obiliqit, që po më drejtohen mua si përfaqësues i tyre.

**Ajet Berisha** – Drejtori më heret tha se parkingu ku ka qenë policia ia kemi dhënë. Unë kërkoj sqarime në mbledhjen e radhës për këtë çështje sepse kam informata gjysmake se kjo parcelë ka qenë private dhe Komuna e ka ble. Pyes, me çfarë forme Komuna një parcelë që e ka ble ia jepë policisë për parking, cili është interesi në rast se ka ndodhë kështu dhe meqë unë nuk kam informata kërkoj informata për këtë parcelë dhe qysh ka shkue mënyra që Komuna i ka dhënë pronë një institucioni tjetër, një Ministrie tjetër dhe për cilin interes.

**Jeton Mjekiqi** – Unë i kam 3 kërkesa.

**Kryesuesja** – Nuk lejohen të bëhen 3 kërkesa në të njejtën seancë të Kuvendit komunal.

**Jeton Mjekiqi** – Nganjëherë po bëhen edhe 3, por nuk është problem. E kemi kërkesën e cila është bërë në vitin 2021 nga Mehdi Mjeku dhe problemi është se ai ka kërkuar me futë një gyp që vjen uji prej malit që po i dëmton edhe arat dhe objektin ku punon. Atij iu ka kthye përgjegje negative derisa ti përfundojmë urat e shkatërruara nga vërshimet, pastaj intervenojmë edhe aty. Unë qysh po e shohë me gypa është pak më problem dhe unë kisha me kërkue me bë me kanal të hapur, i cili vjen prej malit uji që është i pandalshëm sepse nuk ndalet, po hyn në ara po i dëmton dhe po shkon atje te objektet dhe po i dëmton. Kërkesa e dytë është trajtimi i rrugës me zhavorr në lagjen Salihaj, e cila është kogja e domosdoshme për bujqë dhe për tërë lagjen aty. Ndërsa, kërkesën e 3, do ta bëjë në seancën e radhës.

**Sami Ahmeti** – Në mbledhjen e muajit të kaluar të KPF-së, unë e ngrita një shqetësim të disa banorëve të fshatit Bakshi, që thuhet se kanalizimi nga fshati Bardhosh i Komunës të Prishtinës derdhet në arat e Bakshisë, pastaj në përrockën e fshatit, e afër shtëpive kalon ajo përrockë që ka një kundërmim shumë të keq. Unë kam dëgjuar se qytetarët veç janë organizuar dhe kanë me mbyllë në mënyrë të dhunshme atë kanal dhe gjithsesi do të ketë edhe protesta. Kërkojmë që të merret ndonjë masë në këtë drejtim, që besoj se këtë pyetje e kam bërë në një seancë të mëhershme. Deshta ta shtoj edhe kërkesën për një rrugë në fshatin Breznicë, rruga Hysni Hajdari, kemi qytetarë atje që thonë se madje kanë dorëzuar edhe kërkesë, peticion prej 25 personave ndërsa, ajo rrugë anashkalohet për vite të tëra vetëm se pretendohet se ata persona mund të jenë mbështetës të një subjekti politik.

**Ibush Mjekiqi** – Unë po filloj prej çështjes së parafundit kanalizimi në fshatin Bakshi dhe aty nuk është vetëm kanalizimi, por edhe ujërat atmosferike sepse konfiguracioni i terrenit është i tillë. Ne i kemi autorizue Drejtoritë tona përkatëse, kanë pasë takime, janë në bisedime me Drejtorinë përkatëse të Komunës së Prishtinës dhe nuk them se shumë shpejtë do të vjen deri te një zgjidhje. Mendoj se në një periudhë të caktuar do të vjen deri te një zgjidhje e përshtatshme për ata banorë që jetojnë aty. Te kërkesa rruga “Hysni Hajdari” nuk e di cila është më vjen keq nuk mundem me ditë tash dhe nëse, dikush e din kisha pasë dëshirë me ditë se në cilën lagje është dhe sa është e gjatë në mënyrë që ti shikojmë se cilat janë mundësitë për me procedue më tutje.

**Sami Ahmeti** – Tash, saktë nuk është që mundem me ditë se cila është megjithatë, është afër shkollës, kjo pjesa prapa mësuesit Ali, një rrugë përpjetë që shkon. Në atë zonë edhe aty është dikund 500-600 metra.

**Ibush Mjekiqi** – Tash, e di cila rrugë është sepse deshta me ditë se cila është pasi një e kemi futë tani dhe nuk ka pretendime pse janë votues të dikujt tjetër. Ata dikend e kanë votue, sigurisht se janë edhe votues të juaj ose neve dhe me rëndësi është se kanë votue, na kanë sjellë këtu dhe ne jemi tash për me ua rregullue gjërat. Ne në mundësinë e parë kemi me realizue edhe këtë. Te çështja e fasadimit në muajin tjetër na vjen shqyrtimi i KAB-it dhe të gjitha projektet të cilat janë më të mëdha me kosto, duke filluar nga fasadimi, rregullimi i kulmeve edhe pse ne e kemi bërë një studim në vitin e kaluar të 2 banesave, njëra është nën Habitat, e tjetra është pothuajse në prona tërësisht private. Po ashtu, edhe rregullimi i liftit është mirë që në KAB të parashihen si investime kapitale për vitet në vijim.

Te çështja e kanalizimit atmosferik thuhet se përgjegjia është negative, por kërkoj që të ripërsëritet dhe me inxhinjerët tonë do te shohim se si duhet bërë zgjidhja e problemit të atij uji. Sa i përket trajtimit të rrugës me zhavorr, në këtë javë është nënshkruar marrëveshja me kompaninë për trajtimin e rrugëve dhe besoj se brenda 5-10 ditëve, do të filloj rregullimi i këtyre rrugëve me zhavorr.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:10'**

**Bashk.prof.për punë të KK**

  
Azize Zeneli

**Kryesuesja e Kuvendit Komunal**

  
Vlora Mjekiqi Kabashi

